



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Tatim Taksave

Komisioni Juridik dhe i Administrimit

Raport vendimmarrjeje

Nr 3 /Datë 27.082026

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM/QIRA TË SIPËRFAQEVE
TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PËR KORRIDOR LINJE ELEKTRIKE 110 kV
PARKU FOTOVOLTAIK “ Kolonjë “ 30 MW, SHOQERIA “MET INVEST” sh.p.k

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5, pika 4, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Ligji nr.9693 datë, 19.3.2007 “Per Fondin Kullor”, të ndryshuar, Ligji nr.8480, datë: 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë, 13.05.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.267 datë, 27.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 559 datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Udhëzimit nr.1, date 09.06.2016, “ Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhenien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Situata aktuale e funksionit:

Të miratojë dhënie në përdorim/qira të fondit pyjor/kullor në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për korridor linje elektrike 110 kV parku fotovoltaik “ Kolonjë “ 30 MW Shoqeria Met INVEST perkatesisht:

- Gjatësinë prej 0.749 km, pjesë e parcelës Pyjore 26b me numër pasurie 1836 dhe 687 e ndodhur në ekonomia pyjore Qëndër –Gramoz me cilësimin inproduktive sipas Planit të Mbarështimit.
- Sipërfaqja që do të zënë shtyllat 592 m2 ose 0.0592 ha.

Situata financiare: Sipas projekt vendimit dhe relacionit që e shoqeron projekt vendimin.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Pyjeve, Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Kryetari i Bashkisë.

Monitorimi dhe raportimi:

Keshilli I Bashkise Kolonje

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetare te bashkise Konje

A është objekt i konsultimit publik?Jo

Komisioni i Ekonomisë, Financës, Buxhetit dhe Tatim Taksave

Komisioni Juridik dhe i Administrimit, i mbledhur më datë 27.08.2026, shqyrtoi projektvendimin


PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM/QIRA TË SIPËRFAQEVE
TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR PËR KORRIDOR LINJE ELEKTRIKE 110 kV

PARKU FOTOVOLTAIK "Kolonjë "30 MW, SHOQERIA "MET INVEST" sh.p.k. Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
- b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
- c- *Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
- d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes se komisionit.

Alma Zeneli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.08. 2026